



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ARHIKO.ING" Sh.P.K. të datës 14.07.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "ARHIKO.ING" Sh.P.K. e datës 14.07.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 11.07.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "ARHIKO.ING" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "ARHIKO.ING" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 14.07.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (1) - *“Gjatë vlerësimit të ofertave në raportin e vlerësimit është bërë vlerësimi në 10 Ditë, dhe jo 10ditë pune siq ka deklaruar OE dhe ka një dallim, Si dhe në lidhjen e ofertës financiarë OE ka deklaruar se afati për kryerjen e punimeve do të jetë 25. Siq shihet OE ka ofruar 3afate krejtsisht ndryshe nga njera tjetra andaj si i tille Operatori Ekonomik i shpallur fitues është dashur të eliminohet nga procedura dhe jo të favorizohet duke e shpallur fitues”.*

Pretendimi i dytë (2) - *“OE NSH 3 D Projekt, është i pa përgjegjshëm për fakin se i njëjti ka ndërhy ne Panamasë dhe paralogari, jashtëligjshëm dhe ne kundërshtim me dosjen e tenderit dhe dispozitat e LPP-se, sepse nuk mund te ofrohet çmim 0.000”.*

Për shkak të këtyre pretendimeve, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 52, 56, 59, 60, 64, 66 dhe 72 të LPP, pastaj neni 17 dhe 19.11 i RRPP si dhe neni 10 i UPP.

Lidhur me pretendimin e parë: në dosjen e tenderit por edhe në raportin e vlerësimit si kriter vlerësues është përcaktuar afati më deri në 25% të pikëve ku vlerësimi mund të bëhet nga 10 ditë deri në 60 ditë (kalendarike). Ndërsa në planin dinamik tenderuesi i rekomanduar ka përcaktuar se dorëzimi i projektit do të bëhet brenda 10 ditëve të punës që mund të nënkuptojnë 14 ose më shumë ditë kalendarike në rastin konkret. **Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë është i bazuar.**

Lidhur me pretendimin e dytë: fillimisht duhet cekur se përmes nenit 17 par. 17.11 të RRPP është përcaktuar se *“Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tille do të konsiderohet e papërgjegjshme”.* Mbi këtë bazë edhe në formularin e paramasës – përshkrimit të çmimit është vendosur vërejtja për të gjithë tenderuesi ku po ashtu përcaktohet se *“Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës, oferta e tillë do të konsiderohet e pa përgjegjshme”.*

Nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se i njëjti në paramasën-përshkrimin e çmimit me të cilin ka ofertuar ndër të tjera në kolonën me titull *“çmimi i peshuar”* për të gjitha tipet – kategoritë ka vendosur çmime të cilët kanë më shumë se dy (2) numra pas presjes dhjetore përkatësisht ka vendosur çmime me nga katër (4) numra pas presjes dhjetore. **Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë ankimor është i bazuar.**

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Në këtë mënyrë është gjetur se komisioni vlerësues nuk pra vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP si dhe me nenin 17 par. 17.11 të RRPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.07.2023

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimin të këtij vendimi.